




Pranuar / Dorezuar Prijeno / Prejato Received / Delivery	04 - 01 9	viti God Year	
Organ./Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr. Prot: Br. Prot: Prot.No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHUK	27/2019		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRES PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.767/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Lela Petkoviç dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Zyle Millaku-Gojnovci- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.767/2018 të datës 22.11.2018 të parashtruar nga ankuesi Vesel Krasniqi me adresë fshati “Hoçë e Qytetit” në Komunën e Prizrenit, kundër mos zbatimit të Vendimit me Nr. 02-111/155378 të datës 29.10.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prizrenit, në çështjen juridike “kundër mos zbatimit të vendimit të Komisionit të Ankesave”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.12.2018, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar** ankesa me numër A.nr.767/2018 e datës 22.11.2018 e parashtruar nga ankuesi Vesel Krasniqi.
- II. MBETET në fuqi** Vendimi me Nr. 02-111/155378 i datës 29.10.2018 Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prizrenit.
- III. OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Prizrenit që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, njëkohësisht duke e zbatuar Vendimin me Nr. 02-111/155378 të datës 29.10.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prizrenit.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi Vesel Krasniqi ka aplikuar në konkursin e shpallur nga Komuna e Prizrenit për pozitën Drejtor i SHMLM “Lorenc Antoni”, ku në bazë të Formularin E është rekomanduar si kandidat i suksesshëm për

këtë pozitë, mirëpo i njëjti formular nuk është nënshkruar nga Kryetari i Komunës së Prizrenit dhe në bazë të listës së datës 21.09.2018 i njëjti konkurs përsëritet duke mos dhënë arsyetim mbi përsëritjen e konkursit.

Ankuesi kundër mos përzgjedhjes më datë 19.10.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prizrenit. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prizrenit më datë 29.10.2018 ka nxjerr Vendim me Nr. 02-111/155378 me të cilin ka aprovuar ankesën e ankuesit duke e obliguar të shpall listën e kandidatëve të propozuar për drejtor të SHMLM "Lorenc Antoni".

Ankuesi kundër moszbatimit të Vendimit me Nr. 02-111/155378 të datës 29.10.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prizrenit, më datë 22.11.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7045/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.11.2018 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Prizrenit. Komuna e Prizrenit më datë 06.12.2018 ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 22.11.2018 me numër protokolli 7045/2018 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 02-111/155378 të datës 29.10.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prizrenit; Formularin B, C, D, E; Formulari i intervistimit; Lista e datës 21.09.2018; Diplomën e ankuesit; Vërtetimin e datës 04.05.2018 të ankuesit; Certifikatën e lëshuar nga QAPA për ankuesin; Licencën e ankuesit dhe Përgjigja në ankesë e datës 06.12.2018.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit Vesel Krasniqi, **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prizrenit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 02-111/155378 të datës 29.10.2018 me të cilin është aprovuar ankesa e ankuesit dhe duke e obliguar të shpall listën e kandidatëve të propozuar për drejtor të SHMLM "Lorenc Antoni", ka vepruar në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin N.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që me dispozitat ligjore të nenit 82 paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: **"Vendimet e komisioneve për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike dhe për të gjitha palët përkatëse"**, mbi bazë të kësaj Kryetari i Komunës së Prizrenit është i obliguar që t'i ndër marr veprimet në pajtim me dispozitën e lartcekur, duke bërë zbatimin e Vendimit me Nr. 02-111/155378 të datës 29.10.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prizrenit, në kuptim të kësaj pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi. Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048



për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.767/2018

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Zyle MILLAKU-GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit Vesel Krasniqi;
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

